VENDIM
Nr. 64, datë 8.4.2020

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "GEGA-G" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa "e", 5, pika 1, germa "e" dhe të nenit 13 të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të "Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi licencimin e shoqërisë 'GEGA-G' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 10.2.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "GEGA-G" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje u krye njoftimi në medien e shkruar, me shkresën nr. 62/9, datë 11.2.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "GEGA-G" sh.p.k.
- Me shkresën nr. 502 prot., datë 17.2.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "GEGA-G" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 502/1 prot., datë 25.2.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Shoqëria "GEGA-G" sh.p.k. është regjistruar pranë QKB-së në datën 24.8.2001, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", me statusin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara.
- Aplikimi i shoqërisë "GEGA-G" sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- formati dhe dokumentacioni për aplikimin (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Shoqëria ka paraqitur në ERE vërtetimin nr. 12039 prot., datë 17.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, nga i cili rezulton se ndaj shoqërisë "GEGA-G" sh.p.k. është vendosur masa gjobë, për kundërshtimin e së cilës shoqëria ka paraqitur ankim në gjykatën kompetente.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "GEGA-G" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria, në përfundim të procesit gjyqësor, me objekt shfuqizimin e aktit administrativ, "Njoftim vlerësimi për detyrimet" nr. 7647/7 prot., datë 29.3.2016, të depozitojë në ERE vendimin përfundimtar të gjykatës.

3. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti